VENDIM
Nr.114, datë 27.2.2004

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË THIRRJES DHE PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHTETASIT, QË DO TË KRYEJNË SHËRBIMIN E DETYRUESHËM USHTARAK DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.65, DATË 2.2.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR THIRRJEN E SHTETASVE PËR SHËRBIMIN USHTARAK, AKTIV OSE NË REZERVË, KOMPLETIMIN E REPARTEVE USHTARAKE ME REZERVISTË, AUTOMJETE E TEKNIKË TJETËR, KAFSHË PUNE, SI DHE ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË LAJMËRIMIT"

(Ndryshuar me VKM nr. 568, datë 12.8.2005)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkia apo komuna, ku shtetasi ka vendbanimin, detyrohet të lajmërojë dhe të sigurojë paraqitjen e shtetasit, që thirret për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, në qendrat e rekrutim-mobilizimit.

2. Pagesa, për çdo ditë-pune e korrierëve sezonalë për njoftimin e shtetasve për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv ose në rezervë, të jetë sa paga ditore e pagës minimale mujore, në shkallë vendi.

3. Aktivizimi i korrierëve bëhet me urdhër, me shkrim, të kryetarit të bashkisë, njësisë bashkiake ose komunës përkatëse, duke përcaktuar ditët e aktivizimit. Veprimet financiare për pagesën e korrierit kryhen pasi ai të ketë marrë konfirmimin e kryetarit të fshatit ose të administratorit të lagjes, në territorin e të cilit janë shpërndarë fletëthirrjet dhe nënshkrimin e shtetasit, që është njoftuar për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv ose në rezervë. Kur shtetasi që thirret për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv ose në rezervë, ose familjarët e tij, nuk pranojnë ta nënshkruajnë njoftimin, bëhet shënimi në kopjen e fletëthirrjes, duke e nënshkruar, të paktën, edhe një dëshmitar. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer.

4. Qendrat e rekrutim-mobilizimit, në bashkëpunim me bashkitë ose komunat, parashikojnë shpenzimet për pagesat e korrierëve, që realizojnë lajmërimin e shtetasve, në bazë të njësive vendore për çdo vit buxhetor, dhe i paraqesin ato në Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Ministria e Mbrojtjes, me miratimin e buxhetit, bën ndarjen e hollësishme nga buxheti i vet në atë vendor, si transferta të kushtëzuara, për çdo bashki apo komunë, që do të kryejë pagesat për lajmërimin e shtetasve.

5/1. Kryerja e pagesave të korrierëve për thirrjen e shtetasve për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, për vitin 2005, do të bëhet nga qendrat e rekrutim-mobilizimit, pranë çdo njësie të qeverisjes vendore, në bazë të dokumentacionit të përgatitur për këtë qëllim nga kjo njësi vendore.

Dokumentet e nevojshme për kryerjen e pagesave të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

6. Pikat 1,2,3 dhe 4 të kreut II të vendimit nr.65, datë 2.2.1996 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano